



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 2931

NR. VENDIMI 3532

VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqesore Lusjana Fezollari, sot më datë 25. 05. 2021 mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjen civile me Nr. 14478/5564/2931 Regj. Themeltar që i përket :

PADITËS: QENDRA *** organizate jo fitimprurese e regjistruar prane Regjistrin te OJF-ve ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesore Tirane me Vendimin Nr. *** date *** me NIPT ***, me Drejtor Ekzekutiv z. ***, me seli ne ***, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi dt. *** nga Av. **, ne cilesine e avokatit prane studios ligjore “***”, te regjistruar ne QKB me numer NIPT ***, me adrese ne ***.

TE PADITUR: ***, i biri i *** dhe i ***, dtl. ***, lindur dhe banues ne ***, i perfaqesuar ne gjykim me deklarim ne seance nga av. ***.

“***”-person fizik, me emer tregtar *** ose ***, regjistruar me NIPT L91325022C, perfaqesuar nga administratori Z. ***, me adrese ***, i perfaqesuar ne gjykim me deklarim ne seance nga av. ***.

OBJEKTI: 1. Pushimin e menjehershëm te cenimin te emrit tregtar, nderprerjen e konkurrencës se pandershme ne lidhje me ofrimin e shërbimeve te ngjashme te dhena me pare edhe per shogerine *** permes prezantimit me emra apo produkte tregtare te regjistruara nga *** qe kane te bejne me emrat *** apo çdo kombinim i tyre.

2. Shperblimin e demit moral te pesuar si pasoje e shkeljeve ligjore te te paditurit ne favor te paditesit *** ne masen *** lek.

3. Detyrimin e te paditurit te paguaj te gjitha shpenzimet gjyqesore dhe avokatore.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 154, 154/a, 156 te Kodit te Procedurave Civile; Nenet 625/c; 638, 640, 641 e vijues i Kodit Civil. Nenet 156 e vijues te Ligjit Nr. 9947, date 07.07.2009 “Per Pronesine Industriale”, i ndryshuar; Nenet 13, 14 te Ligjit Nr. 9902, date 17.04.2008 “Per mbrojtjen e konsumatorit”, i ndryshuar.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesuesit te pales paditese, i cili kërkoi: Pranimin e kërkesë-padise sipas objektit te saj, perfaqesuesin e pales se paditur,

i cili kerkoi : Rrezimin e kerkese-padise si te pa bazuar ne prova dhe ne ligj, pasi administroi provat shkresore dhe shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj, VEREN :

Se, paditesi Qendra *** organizate jo fitimpruese, nepermjet perfaqesueseve te saj i eshtë drejtuar kësaj gjykate me kerkese-padine me objektin e siperpermendur te saktësuar (pakesuar) si te tille me kerkese te pales paditese ne referim te nenit 185 te K.Pr.Civile.

Si pjese e objektit te kerkese-padise ka qene dhe kerkimi per shperblimi i demit material te ardhur si pasoje e veprimtarise se pandershme te te paditurit..., kerkim per te cilin pala paditese ne referim te Nenit 185 te K.Pr.Civile kerkoi pakesimin e tij, kerkese kjo qe u pranua si e tille nga gjykata nisur nga fakti se eshte ne diskrecionin e pales paditese disponibiliteti mbi objektin e kerkese-padise.

Pas kalimit te ketij momenti procedural, fillimisht, gjykata bazuar ne Nenet 36, 41, 43, 59, 348 te K.Pr.Civile, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykate eshte kompetente nga pikepamja e kompetences lendore e tokesore.

Pala paditese, bazuar ne Nenin 32 dhe Nenin 348 te K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi per te konstatuar ekzistencen e nje konkurrence te pandershme nepermjet perdorimit te nje marke tregtare.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se :

Pala paditëse *** eshte nje organizate jo fitimpruese e regjistruar prane Regjistrin te OJF-ve ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tirane me Vendimin Nr. *** date ***me NIPT *** qe ushtron veprimtarine e saj duke kryer keshillime, trajnime si dhe asistencë teknike ne dobi te organizatave, bizneseve ose individeve qe kerkojne asistencë te specializuar apo synojne rritjen dhe permiresimin e performances se veprimtarise se tyre; te keshilloje dhe te asistojë financimin me kredi te klienteve. Te keshilloje ose asistojë financimet e individeve dhe kooperimeve ne bujqesi; te keshilloj ose asistojë rritjen e performances teknike te individeve, organizatave ose bizneseve duke perfshire dhe bankat dhe institucionet financiare; Asistencë Teknike dhe Operacionale mbi monitorimin dhe vleresimin e programeve zhvilluese, zbatimin e projekteve me qellim zhvillimin e Turizmit, Mbrojtjen e Mjedisit, projekte zhvillimi dhe kerkimore ne fushen e bujqesise, incentivimin e ekonomise dhe punesimin e te rinjve.

Personi Fizik *** me emer tregtare *** ose *** ka si objekt te veprimtarise se tij: Konsulencë ekonomiko-financiare, pergatitje plane biznesi, studime tregu dhe marketingu. Konsulencë bankare dhe asistencë ne teknologji te ndryshme investimi.

Perpara se te regjistrohej me cilesine e subjektit tregtar, personit fizik, z. *** ka pasur nje marredhenie punesimi per nje periudhe prej 5 vitesh me *** e cila ka perfunduar

me ***:

Me perfundimin e kontrates se punes, i padituri pavaresisht se ka patur nje detyrim kontraktor qe te mos punonte vete ose prane te treteve ne veprimtari te ngjashme me ate te parashikuar ne kontraten e punesimit, rezulton se ka perdorur nje emer tregtar te ngjashem me ***, duke u regjistruar me date *** ne regjistrin tregtar si person fizik me NIPT *** me emrin *** emer i cili eshte krejt i ngjashem me ***.

Sherbimet tregtare qe personi fizik “****” ka per objekt te veprimtarise se tij me emrin ***, jane te njejta me sherbimet qe ofron paditesi *** dhe duke pasur nje ngjashmeri kaq te madhe ne emer si dhe natyren e sherbimeve, bazen e njejte te klienteve, kjo gje ka krijuar nje konfuzion te qellimshem ne treg pasi identifikohet lehtesisht me emrin e ngjashem *** dhe nje nga produktet e saj kryesore ***.

Lidhur me kete shkelje dhe shqetesim paditesi *** i eshte drejtuar me ane te perfaqesuesve te tij ligjore z. *** duke i parashtruar problematiken dhe shqetesimin lidhur per problematiken e shkaktuar nga veprimet e z. *** ne shkelje te kontrates se punesimit nenshkruar rregullisht ndermjet paleve. Palet kane vijuar komunikimet midis tyre duke parashtruar faktet dhe kerkesat reciproke dhe ish-punonjesi i paditur, sipas pales paditese ka rene paraprakisht dakord te ndryshoje emrin tregtar po ka refuzuar te nenshkruaj marreveshjen e dakordesuar bashkerisht qe do rregullonte marredheniet ndermjet paleve edhe ne te ardhmen me qellim evitimin e konfuzionit dhe rrjedhimisht mos demtimin e paditesit ***.

Ndodhur perpara nje refuzimi te prere nga z. *** per nenshkrimin e marreveshjes se dakordesuar bashkerisht qe do rregullonte marredheniet ndermjet paleve edhe ne te ardhmen, paditesi *** i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane me qellim garantim e te drejtave te tije ligjore dhe mbrojtjen e markes tregtare te regjistruar dhe produkteve qe asociohen me te, duke u pushuar menjehere nga z. *** cenimi i emrit tregtar, nderprerjen e konkurrences se pandershme ne lidhje me ofrimin e sherbimeve te ngjashme te dhena me pare edhe per shoqerine *** permes prezantimit me emra apo produkte tregtare qe kane te bejne me emrat *** apo cdo kombinim i tyre.

Bazuar ne Ligjin “Per Pronesine Industriale”, nenet 156 dhe 167, perdorimi i emrit tregtar i paautorizuar apo krijimi i konfuzionit per shkak te ngjashmerise midis emrave ose markave eshte i ndaluar me ligj si dhe parashikon paditjen para gjykates te shkelesve te ketyre te drejtave dhe per kete shkak paditesi kerkon pikerisht mbrojtjen e emrit tregtar tashme te regjistruar prej tij.

Emri tregtar *** duke qene prone e paditesit, i jep atij te drejte per te mos lejuar perdorimin e paautorizuar ose perdorimin e emrave qe krijojne konfuzion nga pale te treta sic eshte ne rastin konkret perdorimi nga i padituri i emrit tregtar *** apo i emrave te produkteve qe kane te bejne me emrat *** apo cdo kombinim i tyre, duke pasur parasysh qe gjate kohes qe i padituri ka punuar per *** keto produkte jane trajtuar edhe prej tij. Konfuzioni qe krijohet nga ngjashmeria midis emrave tregtare shkakton dem te pariparueshem te natyres dalluese te emrit *** duke zvogeluar lidhjen e qarte midis emrit tregtar dhe organizates ***.

Veprimet e te paditurit perbejne jo vetem cenim te emrit tregtar, por edhe konkurrence te pandershme. Kjo ka te beje me faktin se i padituri ka punuar per nje periudhe 5 vjecare per *** dhe sic provohet ai ne shkelje te dispozitave kontraktore vazhdon te

ushtroje te njejtin lloj aktiviteti duke i shkaktuar *** deme qe vijne si pasoje konfuzionit te qarte tek klientet.

Sipas kontrates te punes, neni 8.7 i ndalonte te paditurit punesimi ne pozita konkurrenente me *** per nje periudhe nje vjeçare. Nderkohe qe i padituri jo vetem qe nuk e ka zbatuar kete detyrim kontraktor, por kryen konkurrence te paligjshme duke konsumuar ne te njeite kohe edhe cenimin e emrit tregtar ***.

Bazuar ne Vendimin Unifikues Nr. 10 te vitit 2007, demi moral (pretium doloris ose pecunia doloris) eshte shfaqje e brendshme, e perkohshme, e turbullimit te padrejte (non iure perturbatio) te gjendjes shpirtërore te njeriut, dhimbje e vuajtje shpirtërore apo gjendje ankthi e mundimi shpirtëror qe rrjedh si pasoje e faktit te paligjshem. Cilido qe peson cenime ne sferen e shendetit dhe te personalitetit te tij nga veprimet a mosveprimet e paligjshme dhe me faj te nje te treti ka te drejten te kerkoje edhe demshperblimin e demit moral te pesuar.

Gjithashtu, lidhur me Deklaraten e Mbrojtjes qendrimin e pales se paditur ne seancat paraprake e pergatitore dhe provat e sjella nga pala e paditur PF ***, eshte konstatuar se ne argumentet e paraqitura nga z. *** ne Deklaraten e Mbrojtjes prapsohet se:

Emertimi *** nuk eshte i ngjashem me *** dhe nuk mund te kerkohet ne menyre parandaluese ndalimi i perdorimit te disa emrave te cilet i padituri nuk i ka perdorur e as nuk ka ndermend ti perdore.

Nuk mund te kerkohet dem jo pasuror ne formen e cenimit te emrit per subjekte juridike jo natyrore.

Nuk ka shkelje te markes tregtare te mbrojtur ***:

Kontrata e dates *** ka shuar detyrimin per mos konkurrence sipas nenit 4/h te kontrates se konsulences.

Nisur nga keto prapsime pala paditese shprehu se lidhur me pretendimin e pales se emri *** nuk eshte i ngjashem ***, ky pretendim eshte absurd dhe i pakuptimte. Emrat jo vetem qe jane haptazi krejtesisht te ngjashem por po te perdoren shkurtimet apo akronimet e tyre, konkretisht *** dhe *** behen krejtesisht te padallueshme, pasi te dyja subjektet ofrojne te njejtin produkt dhe per me teper z. *** ka punuar per *** me perpara pikerisht me keto produkte.

Pretendimet e pales se sapo ka marre dijeni ka bere ndryshimet ne emrin e tij tregtar, nuk qendrojne pasi ka qene kembengulja e pales paditese e disahershme qe ka sjelle reflektimin e Z. ***. Palet ne kete proces nuk eshte se nuk kane njohje te meparshme dhe se vendosja e emrave te besohet qe ka qene teresisht e rastesishme. Z. *** jo vetem qe ka shkelur parashikimet kontraktore per ndalimin e konkurrences per nje periudhe 1 vjeçare, por ne menyre te qellimshme ka regjistruar nje person fizik me emer krejt te ngjashem dhe ka vijuar veprimtari tregtare.

Pala e paditur pretendon se nuk ka me shkelje te markes dhe nese ka pasur ai pretendon se e ka pushuar tashme cenimin. Ndersa per sa i perket ndalimit te kerkuar nga pala paditese per perdorimin e emrave *** apo çdo kombinim i tyre, pretendon se legjislacioni shqiptar nuk parashikon mbrojtje me natyre parandaluese. Pala ne kete rast me qellim çon argumentet drejt ketij percaktimi, duke vertetuar plotesisht se

shkaqet per te cilen ka paraqitur padine *** jane aktuale dhe konkrete.

Z. *** per gjithe kohezgjatjen e marredhenies se bashkepunimit dhe punesimit prane *** , ka punuar pikerisht ne produkte qe kane emertimet e mesiperme dhe qe ne Shqiperi asociohen vetem me ***. Paditesi *** ka te drejten qe i jep ligji per pronesine industriale qe te mbroje kete emer nga cdokush qe mund ta cenoje ate, dhe jo vetem emrin por edhe cdo produktet i cili eshte lidhur gjithmone me marken e mbrojtur. Konkretisht perdorimi i emrave *** apo cdo kombinim i tyre nga nje subjekt i cili deri dje ishte punonjes i *** dhe qe mban per emer tregtare *** eshte qartesisht shkelje e ligjit dhe eshte bere ne menyre te qellimshme nga ky i fundit me qellim trajtimin si te vetat produktet dhe emrin tregtar te *** , duke krijuar konfuzion tek konsumatori mesatar dhe shtyre kete te fundit te marre vendim te cilin, ne te kundert, nuk do ta kishte marre.

Lidhur me pretendimin e dyte te deklarates se mbrojtjes se “Nuk mund te kerkohet dem jo pasuror ne formen e cenimit te emrit per subjekte juridike jo natyrore”, ky pretendim i pales lidhet me interpretime te tjera te zgjeruara qe kane dukjen e qendrimeve te doktrines juridike.

Paditesi per asnje moment nuk trajton faktin nese emri eshte cenuar apo jo, por merret vetem me faktin se parashikimet ligjore lidhen me persona natyrore. Cenimi i emrit nga ana e PF *** eshte pranuar nga vete i padituri ne deklarate te mbrojtjes, dhe nuk eshte me ceshtje diskutimi. *** duke gene e bindur per kete cenim i ka kerkuar gjykates demshperblimin per demin e ardhur nga cenimi i shkaktuar nga z. ***.

Lidhur me pretendimin se pala paditese nuk ka dem nga perdorimi i emertimit tregtar te ngjashem, perseri vete pala e paditur e cila ka pranuar tashme qe cenimi ka ndodhur, bie ne kundershtrim me sa vete thote ne deklaraten e mbrojtjes. Demi jo vetem qe konsiston ne cenimit e emrit, por edhe ne krijimin e nje gjendje konfuzioni, per te cilen ligji per mbrojtjen e konsumatorit ka siguruar ndalimin e cdo praktike te padrejte tregtare, qe jo vetem ka demtuar *** ne kete rast, por edhe konsumatorin duke shkaktuar konfuzion dhe shtyre kete te fundit te marre vendim te cilin, ne te kundert, nuk do ta kishte marre.

Lidhur me pretendimin se me kontraten e dates *** sipas parashikimeve te pikes 4/h ka perfunduar marredhenia e punesimit, dhe rrjedhimisht edhe detyrimi per ndalimin e konkurrences, ky pretendim eshte i pavend. Kontrata e punesimit ka perfunduar ne date *** dhe nga kjo periudhe Z.*** kishte ndalim ligjore kontraktore sipas pikes neni 8.7 te kontrates se punesimit qe i ndalonte te paditurit punesimi ne pozita konkurrenente me ***-ne per nje periudhe nje vjecare. Veprimet e ndermarra nga Z. *** qe jane dhe objekt i kesaj padie jane kryer pikerisht brenda periudhes se ndalimit.

Lidhur me pretendimet se ceshtja nuk lidhet me praktika tregtare te padrejta dhe se sipas te paditurit ligji ka per qellim mbrojtjen e interesave te konsumatoreve, jemi para kushteve kur pala duke mos pasur njohuri te duhura ligjore, nuk kupton ndoshta se cenimi i tij ne kete rast nuk ka te beje vetem me cenimin e emrit te *** , cenimit te markes tregtare te regjistruar, por dhe demtimin e tregut duke shkaktuar konfuzion e cili rrjedhimisht pasjelle dem ekonomin financiar per palen paditese.

Nga ana e saj pala e paditur prapsoi se: ***, qe nga casti i paraqities se padise, por edhe aktualisht nuk rezulton e regjistruar ne regjistrat e Drejtorise se Pergjithshme te Pronesise Industriale, arsye per te cilen te gjitha prapesimet e paraqitura nga ana e paditur, ***, mbeten te panevojshme, megjithese i padituri ju qendron atyre, sipas percaktimeve te K.P.Civile.

Po ashtu paditesi nuk arriti te provoje se ka realizuar pagesen, sipas parashikimeve te nenit 28/3 K. Punes, i cili parashikon detyrimin e punemarresit per te zbatuar nje marreveshje paraprake me punedhenesin per ndalimin e konkurrences, vetem nese ky i fundit i ofron punemarresit, per periudhen e ndalimin jo me pak se 75 % te pages qe ai do te merrte, por te vazhdonte te punonte per punedhenesin.

Per keto arsye dy argumentet e vena ne themel te padise, si shkak i kerkimeve te paditesit rezultojne teresisht te paqene, arsye per te cilen, sikunder eshte parashtruar edhe ne deklaraten e mbroitjes padia e paditesit rezulton e pathemelte. Per kete arsye ajo duhet te rrezohet. Por edhe pavaresisht sa me siper sikunder eshte parashtruar, rezultoi e provuar se :

Lidhur me kerkesen per pushim te cenimit te markes, sipas nenit 156 te Ligjit Nr. 9947 dt. 7.7.2009 "Per Pronesine Industriale", parashikohet se : "1. Pronari i markes se regjistruar gezon te drejten ekskluzive te perdorimit te markes, ne perputhje me te drejtat e parashikuara ne kete ligj.

2. Pronari i markes se regjistruar gezon te drejten te ndaloje personat e trete te perdorin, gjate ushtrimit te veprimtarise se tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) nje shenje, qe eshte e njejte me marken, per mallra dhe sherbime, qe jane te njejta me ato, per te cilat eshte regjistruar marka;

nje shenje, qe eshte e njejte ose e ngjashme me marken apo qe, per shkak te njellojshmerise apo ngjashmerise se mallrave ose sherbimeve, per te cilat perdoret shenja, me mallrat apo sherbimet, qe mbulohen nga marka e regjistruar, mund te shkaktojne konfuzion te publiku, ku perfshihet edhe mundesia e bashkelidhjes se shenjes me marken tregtare;

nje shenje te njejte ose te ngjashme per mallra apo sherbime, edhe kur keto nuk jane as te njejta e as identike me ato, per te cilat eshte regjistruar marka, ne rast se marka ka reputacion ne Republiken e Shqiperise dhe nga perdorimi i shenjes, pa shkak te arsveshem, realizohet nje perfitim i padrejte ose demtohet natyra dalluese apo emri i mire i markes.

Ne perputhje me piken 2 te ketij neni, gjithashtu, ndalohet: vendosja e shenjes te mallrat ose ambalazhet e tyre; hedhja e mallrave ne treg, ofrimi i tyre per shitje, duke perdorur kete shenje, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave per keto qellime; ofrimi i sherbimeve, duke perdorur kete shenje; g) importimi ose eksportimi i mallrave, duke perdorur kete shenje; d) perdorimi i shenjes ne veprimtarine tregtare, ne reklamime ose publicitete.

Te drejtat, qe i njihen pronarit te markes se regjistruar, sipas ketij neni, i njihen edhe pronarit te markes se mirenjohur ne Republiken e Shqiperise, ne perputhje me percaktimin e shkronjes "g" te pikes 5 te nenit 143 te ketij ligji. "

*Çeshtja ka te beje me pretendimin e paditesit se i padituri *** ne veprimtarine e tij private kishte regjistruar biznesin e tij te vogel me emertimin ***, i cili sipas paditesit eshte nje*

*emertim i ngjashem me marken e regjistruar nga paditesi ****

Ky emertim nuk eshte i njeiti me marken tregtare te regjistruar nga ana e paditesit.

*Megjithate i padituri *** sapo ka marre dijeni per pretendimin e ngritur nga paditesi lidhur me ngjashmerine e emertimit te veprimtarise se tij private me marken e regjistruar te paditesit, pas kerkeses se paditesit, vullnetarisht dhe menjehere e ka ndryshuar emertimin e veprimtarise se tij per te shmangur keqkuptimet nga ana e ketij te fundit, edhe per shkak te faktit se regjistrimi i atij emertimi te veprimtarise se tij private nuk kishte per qellim as perfitimin abuziv nga ngjashmeria me marken e regjistruar te paditesit dhe as ndonje deshire subjektive te te paditurit per t'i shkaktuar dem paditesit. Siç rezulton edhe nga Ekstrakti Historik i regjistrimit tregtar per te dhenat e subjektit "Person Fizik", emri tregtar i regjistruar nga ana e te paditurit ***, si person fizik eshte ***.*

Per kete arsye paraqitja e padise me objekt pushimin e menjehershme te cenimit te emrit tregtar (markes), ne kushtet qe ky cenim edhe po te kishte ekzistuar, aktualisht ka pushuar per shkak te vullnetit te te paditurit, e le padine e paditesit pa objekt.

*Sidoqofte kerkimi i paraqitur nga paditesi lidhur me perdorimin e termave *** apo çdo kombinim i tyre, se pari nuk ka asnje lidhje serish me gjendjen e faktit. Nuk rezulton qe vete paditesi te kete identifikuar ne realitet ndonje veprim te te paditurit lidhur me perdorimin nga ana e te paditurit te ketyre emertimeve.*

Kjo per shkak se nuk verifikohet ndonje kerkese ndaj te paditurit lidhur me perdorimin e ketyre termave ne emertimin e veprimtarise se tij private.

*Se dyti ky kerkim nuk ka asnje lidhje as me te drejta te mbrojtura te paditesit dhe as me parashikimet e ligjit, persa marka e pretenduar e regjistruar e paditesit, edhe nese do te permbushte kerkesat e ligjit eshte *** (***) . Paditesi ka legjitimitet qe te kerkoje mbrojtje juridiksionale vetem lidhur me kete marke. Edhe kesaj pjese te padise i mungon qartesisht aktualiteti, por edhe konkretesia.*

Paditesi deshiron qe te marre paradhenie urdherime gjyqesore kunder te paditurit lidhur me mosperdorimin e ketyre termave ne prezantimin e veprimtarise se tij private. Kjo rezulton edhe nga propozimet e paditesit per marreveshje paraqitur te paditurit kohe me pare. Ky kerkim i padise, sikunder edhe pothuaj te gjitha kerkimet e padise, perben nje abuzim te hapur me te drejten per te ngritur padi.

Per arsyet e siperme padia e paditesit rezulton qe te mos permbaje asnje pretendim, aq me pak te tille, te provuar nga ato qe parashikon dispozita e vene nga paditesi ne themel te kerkimeve te tij (neni 156 i Ligjit Nr. 9947 dt. 7.7.2009 "Per Pronesine Industriale"), si lidhur me reputacionin e markes, mbrojtjen e se cites kerkon ne Republiken e Shqiperise. Per me teper nuk rezulton asnje pretendim lidhur me elementet objektive te parashikuar nga dispozita e sipercituar si "perfitimi i padrejte i te paditurit" apo "demptimi i natyres dalluese te emrit te mire te markes".

*Nuk rezulton jo vetem qe ndonjehere i padituri te kete perdorur si emertim per veprimtarine e tij private marken tregtare te regjistruar nga ana e paditesit, por edhe pretendimi tjeter i paditesit se duke perdorur emertimin tregtar "****" i padituri te mundet te zhvilloje konkurrence te pandershme me paditesin.*

Lidhur me ate pjese te padise ne te cilen pretendohet demi jopasuror si pasoje e cenimit te emrit, te mbeshtetur ne nenin 625 K.Civil, kerkimin e mbeshtetur ne nenin 156 te Ligjit Nr. 9947 dt. 7.7.2009 "Per Pronesine Industriale" ne menyre krejt te pasakte dhe te pambeshtetur ne ligj paditesi e lidh me parashikimet e nenit 625/c te K.Civil, te cilat marrin ne mbrojtje cenimin e se drejtes se emrit dhe jo perdorimin e tij.

Ky pretendim nuk ka te beje me parashikimin e germes "c" te nenit 625 te K.Civil se "eshte cenuar e drejta e emrit". Ashtu siç edhe vete paditesi parashtron ne padine e tij ne piken 16 te saj, pretium doloris apo pecunia doloris (çmimi apo vlera e dhimbjes) jane pasoje e vuajtjes,

brengave, shqetesimeve, anktheve ose dhimbjeve te shkaktuara nga veprime te paligjshme, nje nder te cilat, sipas parashikimeve shteruese te nenit 625 K.Civil eshte cenimi i se drejtes se emrit te personit. Cenimi i se drejtes se emrit, veshtruar ne kontekstin normativ nuk mund te ngaterrohet me cenimin e se drejtes mbi marken e regjistruar.

Ndjenjat qe pasojne cenimet e parashikuara ne nenin 625 K.Civil jane perjashtimisht humane (njerezore). Ato nuk mund t'i perkasin enteve. Cenimi i interesave te ketyre te fundit nuk mund te kete asnje lidhje me pese rastet, te cilat passjellin parashikimin ligjor per shperblim te demit jopasuror, si me poshte : Neni 625 i K.Civil percakton se: Personi qe peson nje dem jo-pasuror ka te drejte te shperblehet kur: eshte cenuar e drejta e emrit;

*Meqenese kerkimi i vetem per demshperblim i parashtruar ne padi eshte ai i mbeshtetur ne nenin 625 K.Civil dhe e drejta e emrit te cenuar eshte marka e regjistruar nga paditesi (***) duhet te parashtrrojme se padia e paditesit edhe ne kete kerkim rezulton e pambeshtetur ne ligj. Sikunder me lart dispozita mbi te cilen mbeshtetet kerkimi i paditesit merr ne mbrojtje te drejten e emrit te personit (njeriut) dhe jo marken e regjistruar.*

Edhe nje interpretim sistematik i nenit 625 K.Civil me piken 5 te tij, ne te cilin ne paragrafin e pare parashikohet se: "Çdo person fizik ka te drejten dhe detyrimin te kete emrin dhe mbiemrin e tij qe i vihen sipas ligjit. Personi, te cilit i mohohet e drejta e perdorimit te tyre ose cenohet nga perdorimi qe te tjeret I bejne padrejtesisht, mund te kerkoje ne gjykate perdorimin e emrit ose te mbiemrit te vet, pushimin e cenimit, si dhe shperblimin e demit perkates".

Perjashton mundesine e ngaterrimit te mbrojtjes se emrit te shtetasit me emertimin e personit juridik, te parashikuar nga neni 27 i ketij Kodi.

Cenimi i se drejtes se emrit, sipas nenit 625 K.Civil passjell pergjegjesine per shperblim te demit jopasuror, ndersa cenimi i te drejtave qe burojne nga marka perbejne elemente te konkurrences se pandershme, e cila passjell pergjegjesi jashtekontraktore, pra te drejten per shperblimin pasuror te demit.

Paditesi nuk rezulton te kete kerkuar shperblim te demit pasuror jashtekontraktor, sepse me ndryshimin e objektit te padise se tij ka hequr dore ne menyre te shprehur nga ky kerkim, por ai as e pretendon ne menyre gjenerike ne padine e tij kete dem.

Lidhur me pretendimin per konkurrence te pandershme, sipas nenit 638 K.Civil, per shkak te perdorimit te nje emertimi te ngjashem me marken e paditesit, pala e paditur parashtrroj se jo vetem qe perdorimi i emertimit te veprimtarise se te paditurit te ngjashem me marken e paditesit nuk eshte me aktual, por padise i mungon çdo perpjekje per te provuar ekzistencen e elementeve te domosdoshem per verifikimin e pergjegjesise jashtekontraktore apo akuilane, te parashikuar nga neni 608 e vijues, posaçerisht neni 638 K.Civil. Ne padine e paditesit nuk verifikohet asnje pretendim konkret per ndonje dem te pesuar, i cili te jete pasoje e drejtperdrejt e veprimeve te paligjshme te te paditurit, te realizuara me faj prej tij.

Por ndersa nuk rezulton sa me siper, paditesi ne ndryshimet e bera ne padine e tij ka hequr kerkimin per shperblim te demit pasuror, qofte ky jashtekontraktor, qofte per shkak te mosrespektimit te detyrimeve kontraktore.

Per keto shkaqe kjo pale kerkoi rrezimin e kerkese-padise si te pa bazuar ne ligj dhe ne prova.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazes ligjore te kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Neni 6 të K. Pr. Civile percaktohet se: "Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet". Nga ana tjetër Neni 16/1 percakton se "Gjykata

zgjdh mosmarëveshjen në përputhje me dipsozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Në analizë të pretendimeve të palëve dhe provave të paraqitura, gjykata çmon se padia e ngritur është e pa bazuar në prova dhe ligj dhe si e tillë duhet të rrezohet, kjo për sa me poshte arsyetohet.

Në nenin 140 i Ligjit Nr. 9947 dt. 07.07.2008 “Per pronesine Industriale” percakton se: “Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta: a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik; b) të përfaqësohen në regjistrë në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj”. Neni 141 i ligjit percakton se: “Një shenjë ka karakter dallues, nëse nëpërmjet saj përdoruesi i zakonshëm dallon një numër mallrash dhe shërbimesh specifike, nga një tjetër numër mallrash dhe shërbimesh, të njëjta me të parat, e lidhur, përkatësisht, me origjinën tregtare të tyre. 2. Karakteri dallues i një shenje vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet, të cilat shenja ka për qëllim t’i dallojë”.

Neni 143 i Ligjit percakton se: “1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:

a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëjlojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkakimit të konfuzionit të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t’u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshëm, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:

a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;

b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;

ç) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave “a” e “b” të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.”

Neni 156 i Ligjit PI, paragrafi 2, parashikon:“Pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij: a) një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka; b) një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare; c) një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshem, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës”.

Neni 184/2 i ligjit përcakton se: “Përbën shkelje të së drejtës, sipas rastit, çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar i disenjos së regjistruar, markës apo treguesit gjeografik, si dhe çdo veprim tjetër që cenon të drejtat e pronarit, sipas neneve 127, 156 dhe 178, të këtij ligji. I njëjti rregull zbatohet edhe për disenjon, markën apo treguesin gjeografik të depozituar në DPPM, për të cilin është bërë kërkesë për regjistrim, sipas këtij ligji.”

Në lidhje me sa u parashtrua më sipër, për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, gjykata çmon se është e nevojshme të zgjidhen çështjet juridike si vijon:

A legjitimohet pala paditese per te kerkuar shperblimin e demit jo-pasuror si person juridik ?
A eshte *** marke e rgjistruar dhe nese jo a gezon statusin e markes se mirenjohur ne Shqiperi ?

A jemi perpara konkureses se pandershme per shkak te sherbimeve te ofruara nga palet ndergjyqese ?

A eshte e vlefshme klauzola e konkureses sipas Nenit 8 pika 7 e Kontrates se Punes ?

Lidhur me pyetjen e pare, gjykata e gjen te drejte arsyetimin e pales paditese per legjitimitetin e saj aktiv ne kete gjykim. Kodi Civil parashikon dy lloj subjektesh të së drejtës, personat fizikë dhe personat juridikë. Ndërsa personat fizikë është e qartë që konsiderohen të gjithë individët, qëniet njerëzore, për personat juridikë doktrina ka formuluar një përkufizim, duke quajtur person juridik çdo subjekt të së drejtës i ndryshëm nga personi fizik, çdo qendër referimi e marrëdhënieve juridike që e drejta i korrespondon, në vend të një qenie humane, një organizimi kolektiv njerëzish (shih Francesco Galgano, E Drejta Private, fq. 113 – 114, Universiteti Luarasi, Tiranë 2006). Personat juridikë ashtu si edhe personat fizikë kanë zotësi juridike (zotësi për të pasur të drejta dhe detyrime juridiko – civile) dhe zotësi për të vepruar (zotësi për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime civile). Duke qenë i tillë, personi juridik mund të hyjë në marrëdhënie juridiko – civile, të fitojë të drejta nga këto marrëdhënie juridiko – civile dhe të ngarkohet me detyrime. Gjithashtu, në të njëjtën linjë logjike, personi juridik është i mbrojtur nga tërësia e legjislacionit e ngritur për të siguruar paprekshmërinë e marrëdhënieve juridike.

Ashtu si personi fizik, edhe personi juridik i gëzon të gjitha cilësitë për të qenë pjesë e qarkullimit civil, ai ka një ka emër, vendbanim (selia e tij) dhe shpreh vullnet në përmbushjen e veprimeve juridike (nëpërmjet organeve të tij, të cilët nuk janë gjë tjetër vetëm se persona fizikë të organizuar në struktura të brendshme, e që veprojnë në përputhje me ligjin, statutin apo aktin e themelimit dhe në emër e për llogari të personit juridik). Edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 16, prg. II parashikon se: “Të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve.”. Në këtë mënyrë Kushtetuta vendos platformën për ndërtimin e një koncepti të drejtë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e personit juridik. Personit juridik, duke qenë një krijesë e së drejtës, që në analizë të fundit synon realizimin e interesave të personave të caktuar fizikë apo të mbarë shoqërisë, i është dhënë e njëjta mbrojtje kushtetuese, duke gëzuar të njëjtat të drejta dhe detyrime si personi fizik, me përjashtim të atyre që lidhen ngushtësisht me qenien e personit fizik (si p.sh, e drejta e jetës, e drejta për të mos i u nënshtruar torturës ose trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës, etj).

Mbështetur mbi këtë analizë, gjykata duhet të shqyrtojë në lidhje me faktin nëse mund të pësojë personi juridik një dëm jopasuror. Neni 625 i Kodit Civil parashikon: “Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij; b) ...”. Nga interpretimi gramatikor që mund t’i bënim termit person që përdoret në fillim të kësaj dispozite, do të thoshim pa hezitim se është fjala për personat në tërësi, personat fizikë dhe personat juridikë. Megjithatë, çështja në pamje të parë komplikohet nga përdorimi i fjalëve “nder” dhe “personalitet”, të cilat krijojnë imazhin e gabuar se, duke qenë cilësi të personit fizik, referojnë vetëm tek ky i fundit.

Gjykata vlerëson se në një interpretim logjik të dispozitës, këtyre fjalëve duhet t’i jepet një kuptim i zgjeruar, duke pranuar që kjo dispozitë të garantojë edhe mbrojtjen e personit juridik nga dëmi jopasuror që mund t’i shkaktohet. Është e vërtetë se në rastin e personit juridik nuk mund të flitet për nder dhe personalitet, por për attribute të cilat qëndrojnë paralelisht me nderin dhe personalitetin, siç janë emri i mirë, reputacioni, fama, etj, që mund të gëzojë një person juridik dhe që mund të jenë subjekt i cënimit. Në këtë përfundim arrijmë edhe po të bëjmë një interpretim sistematik të nenit 625 me nenin 608 të Kodit Civil, i cili ndër të tjera parashikon se: “Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.”. Sigurisht që e drejta e emrit dhe e reputacionit të një personi juridik është e denjë për t’u mbrojtur nga rendi juridik dhe e vetmja mbrojtje juridiko – civile që mund t’i sigurohet është nëpërmjet nenit 625 gërma (a) e Kodit Civil. Kolegjet e Bashkuara të

Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues nr. 12, të datës 14.09.2007, kanë theksuar se: “Dëmi jopasuror, i parashikuar në nenin 625 të Kodit Civil, si një kategori e gjerë dhe gjithëpërfshirëse e dëmeve jashtëkontraktore, përfshin çdo lloj dëmi të pësuar nga cënimi i të drejtave dhe interesave jopasurore Në thelbin e saj, kjo dispozitë njihet të drejtën e dëmshpërblimit për çdo lloj dëmi jopasuror jashtëkontraktor, i cili është i ndryshëm nga ai pasuror. Renditja e rasteve të dëmit jopasuror në paragrafët (a) dhe (b) të saj, nuk ka për qëllim të kufizojë”.

Në mbështetje të sa u tha më sipër edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në disa prej vendimeve të saj është shprehur se personit juridik mund t'i shkaktohet dëm jopasuror: “Në vështrim të praktikës dhe jurisprudencës së saj, Gjykata nuk mundet të përjashtojë mundësinë që një shoqëri tregtare t'i jepet shpërblim pasuror për një dëm jopasuror. Ndërmjet të tjerave, duhet të kihet në vëmendje reputacioni i shoqërisë, pasiguria në vendimmarrje, përçarja në administrimin e shoqërisë dhe së fundi, megjithëse në një shkallë më të vogël, ankthi dhe shqetësimi që i'u shkaktohet anëtarëve dhe bordit drejtues.” (shih vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Comingersoll s.a. kundër Portugalisë). Gjithashtu në çështjen Vereinigung demokratischer Soldaten Österreichs dhe Gubi kundër Austrisë, Gjykata shprehet: “Gjykata pranoi që aplikantit të parë, një shoqate, mund t'i jetë shkaktuar dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së neneve 10 dhe 13 të Konventës”.

Sa i përket çështjes së dytë të shtruar për zgjidhje në arsyetimin e këtij vendimi, gjykata vlerëson se u provua për gjykatën se nuk ka një regjistrim ligjor për marken *** në regjistrin e Markave dhe Patentave në mënyrë që pas këtij veprimi të mund të flitet për mbrojtje të kësaj marke nga cënimi i saj nga të tretet. Ka vetëm një aplikim për regjistrim dhe asgjë më tepër. Vetëm ky aplikim nuk nënkupton regjistrimin e saj. Mjafton ky fakt për të kuptuar se nuk jemi përpara një marke të regjistruar dhe cënimit të saj nga sjellja apo veprimet e të treteve, në rastin konkret nga i padituri.

Nga ana tjetër kushti ligjor i mbrojtjes së markës tregtare, krahas kritereve të tjera ligjore për regjistrim është dhe mirenjohja e saj në vendin ku perdoret si e tillë. Neni 143 pika 5, germa “ç” e ligjit percakton se: “Marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPI-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.

“Markat e mirënjohura” mbrohen nëpërmjet zbatimit të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (1883) e ndryshuar, (Konventa e Parisit) dhe Neni 16 i Marrëveshjes mbi Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (TRIP-s). Qëllimi i Neni 6bis të Konventës së Parisit është të mbrojë markat tregtare të mirënjohura. Vendet e saj anëtare i nënshtrohen detyrimit të refuzojnë ose anulojnë regjistrimin e markave tregtare të cilat janë konfuzive apo të ngjashme me një markë të mirënjohur, apo/dhe të ndalojnë përdorimin e tyre. Parakusht për mbrojtjen e një marke të mirënjohur është ngjashmëria e produktit.

Megjithatë, mbrojtja shtrihet përtej ngjashmërisë së produktit, kur përdorimi i markës tregtare do të shfaqte një lidhje midis produkteve dhe pronarit të markës tregtare të mirënjohur, e cila ndoshta do të shkaktonte dëm pronarit të markës tregtare.

Kriteret ligjore të percaktuara më sipër janë në raport me Konventën që ti japin një marke statusin “marke e mirënjohur” kërkojnë nga gjykata që vlerësimin e tyre ta bëjë në përputhje me kuptimin dhe qëllimin që kanë në vetvete këto terma të përdorura në ligj për raport me rrethanat konkrete. Keshtu koncepti “përdorim” nënkupton për gjykatën se pari përdorimin e saj minimalisht në një grup të caktuar të interesuarish dhe maksimalisht për publikun e gjere dhe se dyti kohezgjatja e këtij përdorimi përben kriter tjetër vlerësues për

gjykatën për dënimin e kësaj statusi. Koncepti i “reklamimit ose publikimit” lidhet me evidentimin e kësaj marke nëpërmjet formave të ndryshme të bërit publike si reklama, spote publicitare, postera, flete-palosje etj. U provua gjyqësisht se kjo marke tregtare është e mirënjohur në tregun shqiptar për sa kohë që ajo si e tillë është tregtuar për një kohë shumë të gjatë dhe vazhdon ende.

Sa me sipër edhe pse kjo marke nuk është e regjistruar perseri nuk jemi përpara ekzistencës së një marke të mirënjohur. Pra ajo nuk gëzon statusin e markës së mirënjohur në kuptim të ligjit 9947 dhe Konventës së Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale” si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit dhe reklamimit të saj tek publiku i sektorit përkatës. Si rrjedhojë, ajo nuk përmbush të gjithë kriteret ligjore të përcaktuara në mënyrë të detajuar në “Rekomandimin e Përbashkët për Mbrojtjen e Markave të Mirënjohura, të Asamblesë së Unionit të Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale dhe Asamblesë së Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” dhe VKM-në nr. 315, datë 31.05.2018 “Për miratimin e rregullores për markat” mbi markat e mirënjohura:

shkalla e njohjes apo njohja e markës tregtare në sektorin publik përkatës;

kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike në të cilën përdoret marka tregtare;

kohëzgjatja, shtrirja dhe hapësira gjeografike e çdo promovimi të markës tregtare, duke përfshirë reklamën ose publicitetin dhe prezantimet, në panairë apo ekspozita, të mallrave dhe/ose shërbimeve për të cilën marka është aplikuar;

kohëzgjatja dhe hapësira gjeografike e çdo regjistrimi dhe/ose e çdo aplikimi për regjistrim të markës, në masën që ato pasqyrojnë përdorimin ose njohjen e markës;

të dhënat e zbatimit të suksesshëm të të drejtave të lidhura me markën tregtare dhe në veçanti, shkalla në të cilën marka është njohur si e mirënjohur nga autoritetet përgjegjëse; vlera e lidhur me markën tregtare.

Kështu, (i) Marka *** *** nuk është mjaft e njohur në tregun shqiptar të shërbimeve.

(ii) Marka *** *** nuk ka një periudhë mjaft të gjatë kohë që përdoret dhe njihet nga publiku në mbarë botën. Kjo markë është shtrirë vetëm në Shqipëri.

(iii) Përsa i përket promovimit të markës *** ***, pala paditëse nuk paraqiti asnjë provë apo informacion për promovimin dhe marketingun e saj.

U provua gjithashtu se pala paditëse ka statusin e një organizate jo fitimprurëse (OJF) dhe jo subjekt tregtar i mirfillte, sipas Neneve 1, 2, 8, 9 të Ligjit Nr. 8788 “Për organizatat jofitimprurëse”. Në këtë kuptim një organizatë jo fitimprurëse nuk ka si qëllim të saj të posaçëm kryerjen e një aktiviteti ekonomik tregtar fitimprurës pasi që një gjë e tillë është e ndaluar me ligj, Neni 56/1 i K.Civil përveç në raport me Nenin 11 të Ligjit Nr. 8788 “Për organizatat jofitimprurëse”. Aktiviteti i saj tregtar mund të kryhet vetëm për qëllime të realizimit të objektit të veprimtarisë së saj dhe jo për qëllime fitimi.

Në lidhje me pretendimin e konkurrencës së pandershme, pavarësisht se konkurrenca e pandershme nuk është trajtuar në mënyrë të gjerë dhe ezauruese në legjislacionin Shqiptar, Kodi Civil ka përcaktuar elementet për të garantuar mbrojtjen ligjore të shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, dhe në nenin 638 parashikon se, “veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: (i) përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; (ii) trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; (iii) përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit”.

Për më tepër, neni 639 parashikon se: “Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së

pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin”.

Në bazë të nenit 156 të Ligjit 9947, pronari i një marke tregtare gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të markës, si dhe njëherazi, ai gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë që të përdorin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij:

një shenjë, që është e njëjtë me markën, për mallra dhe shërbime, që janë të njëjta me ato, për të cilat është regjistruar marka - neni 156 (2)(a);

një shenjë, që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëllojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare - neni 156 (2)(b);

një shenjë të njëjtë ose të ngjashme për mallra apo shërbime, edhe kur këto nuk janë as të njëjta e as identike me ato, për të cilat është regjistruar marka, në rast se marka ka reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe nga përdorimi i shenjës, pa shkak të arsyeshëm, realizohet një përfitim i padrejtë ose dëmtohet natyra dalluese apo emri i mirë i markës – neni 156 (2) (c).

Në përputhje me sa më sipër, ndalohet gjithashtu: a) vendosja e shenjës tek mallrat ose ambalazhet e tyre; b) hedhja e mallrave në treg, ofrimi i tyre për shitje, duke përdorur këtë shenjë, ose krijimi dhe mbajtja e rezervave për këto qëllime; c) ofrimi i shërbimeve, duke përdorur këtë shenjë; ç) importimi ose eksportimi i mallrave, duke përdorur këtë shenjë; d) përdorimi i shenjës në veprimtarinë tregtare, në reklamime ose publicitete.

Për sa më sipër, neni 184 (2) i ligjit 9947 parashikon se përbën shkelje të të drejtës çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar i markës tregtare, si dhe çdo veprim tjetër që çënon të drejtat e pronarit të saj.

Gjithashtu, Kodi Civil [neni 638] parashikon dhe sanksionon veprimet e konkurrencës së pandershme si veprime të kundërligjshme që kryhen prej cilitdo që: përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.

*Për sa më sipër, si dhe bazuar në situatën faktike dhe ligjore të demonstruar në këtë gjykim, konkludojmë se përdorimi i emrave tregtare *** apo ***, nuk përbën shkelje të drejtpërdrejtë të të drejtave të pronësisë industriale të paditësit.*

Nuk u provua me asnje prove nga pala paditese se i padituri eshte i pozicionuar ne treg si konkurrent i drejtperdrejt i pales paditese, apo se ai shet/ofron mallra/sherbime identike nen nje logo qe klientet mund ta perceptojne si nje zgjatim te emrit dhe sherbimit te pales paditese. E gjitha kjo nuk rezulton ne nje konfuzion ne treg, si bashkelidhje midis markave, si dhe ne marrjen e perfitimeve nga reputacioni i emrit tregtar te paditesit.

Persa kohe qe perballe si pale qendrojne nje OJF me status te kufizuar ligjor per veprimtari tregtare me nje subjekt tregtar « person fizik tregtar » elementet e nenit 638 te K. Civil nuk jane proporcional per tu krahasuar midis tyre.

Perpos kesaj nuk u provua nga pala paditese specifikisht se cila ishte konkurenca dhe ne ç'menyre ai kishte persuar deme nga veprimtaria e pales se paditur. Ne nje ekonomi tregu te lire parimisht monopoli i veprimtarise tregtare nuk eshte atribut ekskluziv i nje subjekti te vetem persa kohe qe kete gje ai nuk e provon ligjerisht me nje kontrate ligjore ekskluzive.

Vetem ne kete menyre do te mund te gezoje mbrojtje ligjore kundrejt te treteve dhe pretenduar pushimin e ketij cenimi apo demin efektiv te mundshem. Sa me siper persa kohe qe nuk ka nje cenim nuk mund te kete dhe nje pushim te ketij cenimi.

Lidhur me pretendimin e demit jo-pasuror, gjykata çmon se konflikti gjyqesor buron nga marrëdhënia juridike e demshperblimit jashtë kontraktor e cila gjen rregullim ne Nenet 608, 625/a e vijues te K. Civil. Ky nen (608) jep përkufizimin e shkaktimit të demit. Sipas kësaj dispozite: “Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj i shkaktonte tjetrit një dëm në personin ose pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar.”

Neni 609 i K. Pr. Civile percakton se: “Demi duhet te jete rrjedhim i drejtperdrejt dhe i menjehershëm i veprimit ose mosveprimit te personit”.

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se katër janë kushtet që të lindi detyrimi nga shkaktimi i demit jashtë kontraktor. Konkretisht: a) të ekzistojë dëmi (që në rastin objekt gjykimi, lidhet me cenimin e nderit dhe personalitetit të personit); b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) lidhja shkaksore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (dëmit) të ardhur. Të katër këto kushte duhet të qëndrojnë bashkarisht (në mënyrë kumulative) që të ekzistojë detyrimi.

Veprimi i paligjshëm ne shkaktimin e demit cilesohet nje kategori objektive, shfaqja e kundraligjshme e vullnetit te subjektit te se drejtes qe sjell si pasoje shkeljen ose cenimin e te drejtave, lirive dhe interesave te te treteve qe mbrohen nga rendi juridik dhe zakonet e mira. Kundraligjshmeria e sjelljes se subjektit shkaktar te demit cenon marrëdhëniet juridike, qe gezojne mbrojtje nga Kushtetuta, aktet nderkombetare, ligjet dhe aktet nenligjore, te cilat njohin dhe garantojne te drejtat e personave fizik dhe juridik ne raport me njeri-jetrin dhe pushtetin publik.

Faji eshte qendrimi subjektiv i personit shkaktar te demit ne raport me veprimin e kundraligjshem dhe pasojat qe vijne prej tij, qe nenkupton vullnetin e brendshem psikik per te kryer veprimin, per te siguruar ardhjen e pasojave ose lejimin e ardhjes se tyre.

Lidhja shkaksore vleresohet si ekzistenca e lidhjes objektive, te drejtperdrejte dhe te pavarur nga vullneti i subjektit shkaktar te demit mes veprimit te kundraligjshem dhe pasojes se ardhur. Lidhja shkaksore verteton lidhjen mes tre elementeve objektive dhe subjektive te faktit te paligjshem; konkretisht sjelljes se paligjshme, fajit dhe pasojes se ardhur, pra demit te shkaktuar ne pasurine, shendetin ose personalitetin e subjektit te demtuar. Elementi i lidhjes shkaksore mbeshetet ne parimin condicio sine qua non sipas te cilit nuk do te vertetohej ardhja e pasojes se demshme nese nuk do te kishte ndodhur shkaku, sjellja e paligjshme dhe faji per shkaktimin e demit.

Demi i cili mund te kete karakter pasuror ose jo-pasuror.

Neni 625 i Kodit Civil parashikon se: “Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur: a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij

Gjykata vlereson se analiza e katër elementëve të parashtruar më lart, duhet bërë në linjë kronologjike, duke shqyrtuar nëse përmbushet secili element më vehte.

Ne rastin objekt shqyrtimi nuk provohet ekzistenca e asnje elementi te demit jashtkontraktor. Kjo pasiqe nuk provohet kundraligjshmeria e veprimeve te pales se paditur ndaj paditesit dhe rrjedhimisht mungojne dhe elementet e tjere te fajit dhe lidhjes shkaksore e me tej dhe te demit konkret.

Lidhur me pergjigjen e pyetjes se katert qe lidhet dhe me objektin e kerkese-padise, gjykata vlereson se Neni 28 i K. Punes percakton se: “Punëmarrësi mbi 18 vjeç mund të zotohet me shkrim kundrejt punëdhënësit që, pas përfundimit të marrëdhënies së punës, të mos i bëjë atij konkurrencë në një sipërmarrje konkurruese duke punuar ose duke u

interesuar për të. (2) Punëmarrësi ndalohet të bëjë konkurrencë kur, nga raportet e punës, ai ka dijeni për sekretet e fabrikimit ose të veprimtarisë së punëdhënësit dhe kur përdorimi i këtyre të dhënave e dëmton rëndë punëdhënësin. (3) Punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë respektimin e ndalimit të konkurrencës kur shpërblen punëmarrësin gjatë periudhës së ndalimit me jo më pak se 75 për qind të pagës që ai do të merrte, nëse do të punonte. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi bazën e pagës mesatare të vitit të mëparshëm dhe indeksohet”

Neni 29 percakton se: “(1) Në kontratë duhet të përcaktohet qartë ndalimi i konkurrencës lidhur me vendin, kohën dhe llojin e veprimtarisë, për të mos dëmtuar të ardhmen ekonomike të punëmarrësit. Afati i ndalimit është jo më shumë se 1 vit. (2) Gjykata, duke mbajtur parasysh të gjitha rrethanat dhe kur e çmon të arsyeshme, mund të reduktojë ose të zgjasë periudhën e ndalimit të konkurrencës brenda afatit të përcaktuar në paragrafin e mësipërm të këtij neni”.

Neni 30 percakton se: “(1) Ndalimi për të bërë konkurrencë përfundon kur punëdhënësi nuk ka më interes që ky ndalim të vazhdojë. (2) Ndalimi përfundon kur punëdhënësi zgjidh kontratën pa shkaqe të arsyeshme ose kur punëmarrësi zgjidh kontratën për një shkak të arsyeshëm që lidhet me punëdhënësin”.

Pare keto kushte ligjore ne raport me percaktimet që palet me vullnetin e tyre të lire kane bere ne kontraten individuale te punes, per gjykatën konstatohet se keto percaktime ne kontrate nuk jane koherente, te ligjshme dhe te detyrueshme per zbatim.

Neni 660 i K. Civil percakton se: «Palet ne kontrate percaktojnë lirisht permbajtjen e saj brenda legjislacionit ne fuqi».

Neni 676 i K. Civil percakton se: «Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë tëndërsjelltë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Shfaqja e vullnetit mund të jetë e shprehur ose në mënyrë heshtësore.».

Koncepti juridik i detyrimit percakton se: “Detyrimi është një marrëdhënie juridike me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditore), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi. Detyrimet lindin nga kontratat ose nga ligji. Kreditore dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, me paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes”.

Neni 698 i K. Civil percakton se : « Në kontrata me detyrime të ndërsjellta, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese, sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të demit”.

Per natyren specifike te punes qe i padituri ka kryer prane pales paditese me te drejte nga ana e ketij te fundit ne kontraten formale te dt. *** dhe ne vijim ne kontratat e tjera te punes te nenshkruara bashkarisht, eshte shtuar si klauzole detyruese per zbatim ajo e “ndalimit te konkurences” e percaktuar ne nenin 8 pika 7 e kontrates.

Fakti qe kjo klauzole eshte percaktuar si e tille ne kete kontrate per te paditurin me detyra specifike prane pales paditese nenkupton faktin se te dy palet kane qene ne dijeni te ketyre ndalimeve, i kane njohur dhe pranuar ato dhe kane marre persiper dhe detyrimin per zbatimin e tyre.

Por i vertete eshte edhe fakti se nga pala paditese respektimi i detyrimeve qe i perkisnin asaj si nga Neni 28/3 i K. Punes dhe neni 8/7 i kontrates “dhenia e 75% te pages per efekt te ndalimit te konkurences” nuk jane zbatuar si te tilla. Kjo gje provohet me provat shkruesore te administruara dhe me pohimet reciproke te paleve.

Keshtu, persa kohe qe vet pala paditese nuk ka permbushur detyrimin e saj ligjor per pagimin e kesaj page pergjate periudhes se mbulimit 1-vjeçar, atehere ligjerisht nuk mund te pretendojë te drejta vetjake pasiqe keto kushte qendrojnë kumulativisht. Kjo ne kuptimin qe vetem pasi ish-punëdhënësi te kete paguar shumen prej 75% te pages mujrore

per nje vit rresht si gjate zbatimit te kontrates si shtese e pages efektive apo dhe pas perfundimit te kontrates, vetem atehere ai mund te pretendoje ndalimin e konkurences dhe gjithashtu dhe demin ne rast te shkeljes se saj nga punemarresi, i padituri ne rastin konkret. Persa kohe qe provohet se ky detyrim nuk eshte permbushur atehere dhe kjo e drejte e pretenduar nuk mund te mbrohet gjyqesisht.

Sa me siper u arsyetua, kerkese-padia ne teresine e saj eshte e pa bazuar ne ligj dhe ne prova dhe duhet rrezuar.

PËR KËTO ARSYE :

*Gjykata bazuar ne Nenet 126, 306 e vijues, 444 te K. Pr. Civile,
VENDOSI :*

Rrezimin e kërkesë-padisë.

Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te palës paditëse.

Kundër këtij vendimi lejohet të behet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve afat që ky qe fillon nga e nesërmja e njoftimit te vendimit te arsyetuar paleve ndergjyqese.

U shpall sot me dt. 25. 05. 2021 ne Tirane.

SEKRETARE

GJYQTAR

LUSJANA FEZOLLARI

ERVIN POLLOZHANI